

V E N D I M
Nr.711, datë 21.10.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.360, DATË 10.7.1995 "PËR REGJIMIN E EKSPORT-IMPORTIT NGA DHE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.415, DATË 7.8.1995 DHE VENDIMIN NR.121, DATË 12.2.1996 V E N D I M B L I K Ë N E S H Q I P Ë R I S Ë", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.415, DATË 7.8.1995 D

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.360, datë 10.7.1995 "Për regjimin e eksport-importit nga dhe në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me vendimin nr.415, datë 7.8.1995 dhe vendimin nr.121, datë 12.2.1996, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 2, paragrafi me përmbajtjen:

"Dru i sharruar apo i prerë për së gjati, i prerë në feta apo i qëruar, nëse është apo jo zdrukthuar, poliruar me shpan apo ngjitur nga kllapat bashkuese të një trashësie më tepër se 6 mm" ndryshohet dhe zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

"Dru i sharruar ose i prerë për së gjati, i kthyer në feta ose fletë, edhe i planosur, i pastruar ose i ngjitur me bashkime me kapse me trashësi më të madhe se 6 mm, përjashtuar binarët e planosur, pastruar ose ngjitur me bashkime, të cilët lejohen të eksportohen lirisht".

b) Në pikën 2 të këtij vendimi, paragrafi i shtuar me pikën 2 të vendimit nr.12, datë 12.2.1996, me klasifikimin 44.09, shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregisë të nxjerrë udhëzimin përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi